



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:006369

Datë: 11.02.2022

Numri i dokumentit: 02704213

PKR.nr.6/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, me Kryetarin e Trupit Gjykses – Gjykatësi **Drilon Haraçia**, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, kundër të akuzuarit N. (A.) M.nga fshati . . . Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale gjueti e kundërligjshme nga neni 350 par.2 lidhur me parag.1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër PP/L.nr.03/2022 të datës 19.01.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar - publik me datën 10.02.2022, në prezencën e Prokurores së Shtetit Dëshire Jusaj dhe të akuzuarit, **me datën 11.02.2022**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N. M., i biri i A., nënës S., e gjinisë R., data e lindjes . . . , në fshatin . . . , Komuna e Rahovecit, ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën fillore, me profesion bujk, i divorcuar, baba i 4 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

I.Sepse me datë 19.12.2021, pa leje gjuetie apo pa autorizim për gjuajtje dhe në kohën kur gjuetia është e ndaluar e në kundërshtim me Ligjin nr.02/L-53 për Gjuetinë, ka shkuar në terrenin e fsh. . . për gjuajtje, ashtu që ditën kritike i pandehuri me armen e llojit pushkë gjuetie “Sifsan” 12 mm, të Prodhimit Turk, vret një lepur, e më pas e merr dhe e vendos në bagazhin e veturës të tipit “. . .”, me targa . . . , ashtu që me tu ndalur nga policia rreth orës 01:45 min të datës kritike, të njëjtit i është gjetur lepur i vrarë në bagazhe, e që këtë e kishte bërë pa ndonjë leje përkatëse për gjueti dhe jo në sezonin e lejuar për gjueti sipas njoftimit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural pranë Komunës së Rahovecit me nr.555 të dt.17.11.2021.

- **Me çka ka kryer veprën penale gjueti e kundërligjshme nga neni 350 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK- së.**

II.Sepse më parë ka siguruar e gjerë me dt.19.12.2021, në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-022 për Armët, mbanë në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, armën e llojit pushkë gjuetie “Sifsan” 12 mm, të prodhimit Turk, me nr.serik 145519 dhe tre fishekë Sterling-12mm, në atë mënyrë që pasi është ndalur nga policia datën kritike rreth orës 01:45min në fsh. . . ., të njëjtit i është gjetur arma me të cilën e ka vrarë lepurin, të cilën fillimisht i pandehuri e kishte hedhur jashtë veturës, e që më pas arma i konfiskohet bashkë me tre (3) fishekët nga zyrtarët policor.

- **Me çka ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve **4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, 70**, dhe nenit 350 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 366 par.1 dhe par.3 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- **Për veprën penale nën pikën e I të dispozitivit të aktgjykimit, ME DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **300.00 € (treqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata të akuzuarit ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve**, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.
- **Për veprën penale nën pikën e II të dispozitivit të aktgjykimit, ME DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **700.00 € (shtatëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata të akuzuarit ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej **35 (tridhjetë e pesë) ditëve**, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

Ndaj të akuzuarit konfiskohen: 1 (një) pushkë gjuetie “Sifsan” 12 mm, e prodhimit Turk, me nr. serik 145519 si dhe 3 (tre) fishekë Sterling-12mm, si objekt i veprës penale.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 50 (pesëdhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/L.nr.03/2022 të datës 19.01.2022, kundër të akuzuarit N. (Ali) M.nga fshati . . . , Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale gjueti e kundërligjshme nga neni 350 par.2 lidhur me prg.1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Prokurorja e Shtetit Dëshire Juasaj, gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë akuzës së përmirësuar ndaj të akuzuarit të lartcekur duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

I akuzuari N. M., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale sipas pikës I të aktakuzës për të cilën akuzohet. Po ashtu ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas pikës II të aktakuzës, ka shtuar se është penduar për kryerjen e veprave penale, se është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, i ka propozuar gjykatës që të ketë parasysh një dënim sa më të lehtë, marr parasysh gjendjen e dobët ekonomike dhe at se është baba i katër fëmijëve dhe at mundësisht që ti shqiptohet një dënim me gjobë i arsyeshëm për shkak të pasojave ligjore.

Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë së bërë nga ana e këtu i pandehuri N. M.për veprat penale për të cilat akuzohet, ky pranim fajësisë është në përputhje të plotë me provat të cilat ndodhen në shkresat e lëndës, andaj gjykatës i propozojë që këtë pranim të fajësisë ta aprovojë.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së, gjatë pranimit të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurorja e shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari N. M., me dashje ka kryer veprën penale Gjueti e kundërligjshme nga neni 350 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

4. Elementet e veprave penale

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen: *“Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”*.

Në nenin 350 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale gjuetia e kundërligjshme e kryen *“Kushdo që pa leje ose autorizim, gjuan ose mbyt një kafshë të egër ose e zë të gjallë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj”, ndërsa në paragrafin I parashihet se “Kushdo që gjuan kafshë të egra kur gjuetia është e ndaluar ose në territorin në të cilin gjuetia është e ndaluar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”*.

5. Vendimet e kryetarit të trupit gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, Kryetari i Trupit Gjykues të akuzuarin N. M., e ka shpallur fajtor sipas aktakuzës, ngase në veprimet e të akuzuarit në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale gjuetia e kundërligjshme nga neni 350 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa në dispozitivin e II të këtij Aktgjykimi formohen të gjitha elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që edhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar për veprat penale për të cilat ngarkohet, faktin se është i gjendjes së dobët ekonomike. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i njëjti ka qenë i dënuar sipas vendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë me numër të lëndës P.nr.64/18 të datës 20.05.2019, për shkak të veprës penale shantazhit nga neni 341 par.1 të KPRK-së, i cili

ka qenë i dënuar me burgim njëmbëdhjetë (11) muaj me kusht për dy (2) vite dhe me dënim me gjobë në shumë prej 900,00 €. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimeve nga neni 38 dhe 43 i KPRK-së dhe këto dënime si i tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Konfiskimi

Gjykata ndaj të akuzuarit konform neneve 366 par.3 të KPRK-së, ka bërë konfiskimin e: 1 (një) pushke gjuetie “Sifsan” 12 mm, e prodhimit Turk, me nr.serik 145519 si dhe 3 (tre) fishekë Sterling-12mm, si objekte të kryerjes së veprës penale.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.6/22, me datë 11.02.2022

Zyrtarja Ligjore,
Arbënore Basha

Kryetari i Trupit Gjyqësor- Gjykatësi,
Drilon Haraçia

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.